

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“ ELG ENERGY ” sh.p.k.

Themeluesit që firmosin më poshtë:

- 1) **Arqile Pojani**, i biri i Kocit dhe Dafines, shtetas Shqiptar, lindur me 17 Nëntor 1961 në Fier dhe banues në Tiranë, Rruga Selman Qosja, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. 034066053 dhe Nr. Personal G11117076L.
- 2) **Eduela Sefgjini**, e bija e Mark dhe Tereza, shtetase Shqiptare, lindur ne 08 Mars 1992, ne Madhesh dhe banuese ne Tirane, Rruga Skender Luarasi, Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e Pasaportes Nr. BC1819167 dhe Nr. Personal J25308074N.
- 3) **Eduart Ciko**, i biri i Stavrit dhe i Violetes, shtetas Shqiptar, lindur ne 02 Mars 1964, ne Karbunar dhe banues ne Tirane, Rruga Mihal Grameno, Tirane , madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Pasaportes Nr. BR3845499 dhe Nr. Personal G40302193H.

Që në vijim do të quhen **Ortakë**,

sot më datë 19 Nentor 2022, me vullnetin e tyre të lirë, bazuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendosën të themelojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë:

Kreu I

OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ELG ENERGY” sh.p.k., do të zhvillojë aktivitetet me objektin e veprimtarisë si më poshtë:



- Projektimi, implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaik, eolike, hidrike) te prodhimit te energjise, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme si dielli, era, uji, si dhe i veprave, infrastruktures ndihmese te tyre. Prodhimin dhe shitjen me shumice apo pakisa, e energjise elektrike, tek operatoret, furnizuesit, tregtaret, konsumatoret, e energjise elektrike, (venda apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjise Elektrike, apo ne bursa te tjera jashte vendit.;
- Ofrimi i konsulencave, per te tretet, ne lidhje me projektimin, ndertimin, implementimin dhe menaxhimin e impianteve per prodhimin e energjise se me burime te rinovueshme. Kryerja e aplikimeve, per pajisjen e lejeve, licenceve, autorizimeve paraprake/ perfundimtare, me qellim zhvillimin e ketyre aktiviteteve, per vete apo pale te treta. Kryerjen e stidimeve te fizibilitetit, si dhe importim, shit/blerje te pajisjeve per ndertimin e impianteve te prodhimit te energjise nga burime te rinovueshme. Zbatimin e projekteve, deri en venien ne funksionim te impianteve.
- Ndërtimi dhe shfrytëzimi i impianteve të përpunimit të mbetjeve. Import – eksporti i tyre.
- Pjesëmarrje në investimet industriale dhe tregtare, si dhe në aktivitete të ndryshme financiare, tregtare e industriale;
- Blerja, shitja, marrja/dhënia me qira e pasurive të paluajtshme;
- Përfaqësimin e shoqërive të ndryshme, shqiptare apo të huaja, që kanë objekt të njëjtë apo të përafërt me atë të kësaj shoqërie.
- Në përgjithësi te gjitha aktivitetet industriale, tregtare, financiare, civile, te luajtshme ose te paluajtshme, qe mund te lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqërisë ose me objekt te ngjashëm ose te përafërt.
- Çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2. Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

2.1. Emërtimi i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar është: “ELG ENERGY “ sh.p.k..

2.1.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Durrës, Rr. Fetah Bllaca, Lagjia Nr. 4, Pall 1133.

- 2.1.2. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3. Regjimi juridik

- 3.1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
- 3.2. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të ndryshohet regjimi juridik i Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast do të përshtaten dhe aktet themelore të shoqërisë.
- 3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II

TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA

Neni 4 Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve

- 4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak/aksioner në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.
- 4.5. Ortakët marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.
- 4.6. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Shoqërisë. Për këtë gëzon të drejtën që të caktojë një person të emëruar prej tij që të marrë informacion.

Neni 5 Kohëzgjatja

- 5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.



Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar "ELG ENERGY" sh.p.k., është 100 000 (njëqind mije) Lekë dhe është i ndarë në 3 kuota me vlerë nominale sipas përcaktimeve më poshtë. Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

6.2 Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

- (i) z. Arqile Pojani 1 (një) kuotë me pjesemarrje ne perqindje ne masen 33.4% të kapitalit me vleren 33 400 (tridhjete e tre mije e katerqind) Lekë;

- (ii) znj. Eduela Sefgjini 1 (një) kuotë me pjesemarrje ne perqindje ne masen 33.3% të kapitalit me vleren 33 300 (tridhjete e tre mije e treqind) Lekë;

- (iii) z. Eduart Ciko 1 (një) kuotë me pjesemarrje ne perqindje ne masen 33.3% të kapitalit me vleren 33 300 (tridhjete e tre mije e treqind) Lekë;

Kreu IV

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 7

- 7.1 Organet e shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Administratori.
- 7.2 Vendimet në shoqëri merren nga Asambleja e Përgjithshme. Këto vendime shënohen në Librin e Mbledhjeve të Shoqërisë që shërben edhe si Regjistër i Vendimeve të Asamblesë.
- 7.3 Administratori i Shoqërisë dhe eventualisht eksperti kontabël i autorizuar caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Kreu V



ADMINISTRIMI

Neni 8

- 8.1 Administrimi i Shoqërisë do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.
- 9 Shoqëria do të drejtohet nga Administratori **znj. Xhoia POJANI**, e bija e Arqilese, e datëlindjes 04/10/1992, lindur në Fier e banues në Tirane, Rruga Selman Qosja, Tiranë identifikuar me letërnjoftimin ID nr. 037045599 dhe Numer Personal J26004061B.
- 9.1 Administratorja do të qëndrojë në detyrë për një afat prej 5 (pesë) vjet me të drejtë riemërimi.

Kreu VI


DISPOZITA TË TJERA

Neni 9


- 9.1 Fitimi i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore, i mbetet Ortakëve në raport me pjesët e kapitalit që zotërojnë.
- 9.2 Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKËT E SHOOËRISË

Arqile POJANI

Arqile Pojani 

Eduela SEFGJINI

Eduela Sefgjini 

Eduart CIKO

Eduart Ciko 